Raporti Vjetor i Punës

2012

PRISHTINË

MARS, 2013

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e te Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2012

PRISHTINË
Mars, 2013

Në përpjekje të një raportimi standard tashmë Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, para organit më të lartë në nivel vendi, Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj, për herë të parë del me raportin e saj të punës njëvjeçare, duke hyrë kështu me suksese domethënëse, në vitin e dytë të punës, ndonëse suksese pozitive janë raportuar edhe në gjashtmujorin e vitit 2011, vit ky i themelimit të këtij institucioni.

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili ka filluar të zbatohet në Republikën e Kosovës, në parim, është pjesë përbërëse e lirive fundamentale dhe të drejtave të njeriut, njëherit është parim bazë i vendosur në preambulën e Deklaratës Univerzale të të Drejtave të Njeriut të OKB-së.

Që nga viti 1995, të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian e kanë për detyrë që gjithë legjislacionin e tyre ta harmonizojnë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të nxjerrë nga secili shtet, ligj ky i cili do të jetë i derivuar nga Direktiva EC 95/46 si dhe konventat e protokollet e kosideruara, në përputhje të plotë me këtë Direktivë. Kjo përshtatje në fushën e mbrojtjes së të dhënave me Acquis Communautaire të BE-së, tashmë ka kaluar kufijtë e BE-së dhe shumë shtete të kontineteve tjera janë duke aplikuar Konventën 108 të vitit 1981 dhe dokumentet tjera relavante juridike për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë.

Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si institucion i mandatuar për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në të gjitha institucionet brenda vendit tonë, si dhe përfaqësitë tona zyrtare jashtë shtetit, në të dy sektorët, atë privat dhe publik, ka shënuar rezultate të prekshme dhe kurajuese, duke qenë kështu autoritet i konsideruar nga institucionet relavante në rajon dhe BE.

Hartimi i këtij raporti për periudhën e vitit 2012, në fakt, pasqyron angazhimin e madh të Këshillit të Agjencisë dhe stafit të saj, për aktivitetin e bërë në këtë fillim pune të këtij institicioni. Raporti nuk do të fokusohet shumë në sfidat dhe përpjekjet për ngritjen e institucionit, të domosdoshëm në zhvillimet e reja të demokracisë, sundimit të ligjit, lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe zhvillimeve kolosale të teknologjisë së komunikimit njerëzor. Në fakt, raporti synon të nxjerrë në pah detyrat ligjore, në njërën anë për institucionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat e qytetarëve, për të pasur sa më tepër njohuri mbi të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë. Suksese kurajuese, raporti thekson në hartimin e legjislacionit sekondar, ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimit në mbrojtjen e të dhënave në Adminstratë Publike, Sistemin Bankar, në Telekomunikacion, në fushën e vëzhgimit me kamerë në të dy sektorët në nivel vendi, në bashkëpunim ndërkombëtarë etj. Janë përmbushur të gjitha obligimet dhe detyrat që raporti i progresit ka fokusuar për ASHMDHP, në afat rekord, pa lënë anash inspektimet, hetimet dhe kontrollet në institucionet private dhe shtetërore të vendit tonë.

Agjencia, me përkushtim ka vendosur të gjitha kapacitet e veta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë në kuadër të zbatimit të ligjit 03/L-172, duke ditur se ky është edhe interesi jetik i shtetit (shoqërisë) dhe qytetarëve tanë, si parime bazë të derivuara nga Daklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB-se, Konveta për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut e KE-së, Konventa 108 e vitit 1981 dhe Direktiva EC.95/46 e KE-së. Në këtë drejtim kemi bashkëpunuar me të gjitha institucionet tona dhe shoqërinë civile në nivel vendi si dhe institucionet relevante të KE-së, Komisionit Evropian dhe institucionet simotra në rajon për realizimin e objektivave të synuara nga Agjencia.

Përmbajtja e Raportit

1. Hyrje 5
2. Korniza Ligjore 6
3. Përgjegjësitë dhe Autorizimet 7
    3.1 Përgjegjësitë 7
    3.2 Autorizimet. 8
    3.3 Misioni 9
    3.4 Vizioni 9
    3.5 Aktet Nënligjore të Agjencisë 10
        3.5.1 Akte Nënligjore 10
        3.5.2 Dokumente Administrative 10
4. Raporti i Progresit - Liberalizimi i Vizave 11
5. Aktivitetet e Agjencisë në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale 11
    5.1 Organizimi i Agjencisë 11
        5.1.1 Këshilli 11
        5.1.2 Departamentet 12
    5.2 Këshilla dhe Opinione 13
        5.2.1 Projekt – Ligje 16
        5.2.2 Projekt – Rregullore 17
        5.2.3 Projekt - Udhëzime Administrative 17
        5.2.4 Draft-Marrëveshje 17
    5.3 Ankesat 17
    5.4 Inspektimi dhe Kontrolli 18
        5.4.1 Inspektime të Përgjithshme 19
        5.4.2 Inspektimet Sipas Ankesës 21
        5.4.3 Inspektimet sipas detyrës zyrtare 21
        5.4.4 Përpunimi i të dhënave biometrike 22
    5.5 Transferimi i të Dhënave 23
    5.6 Harmonizimi dhe Përafrimi i Legjislacionit 25
    5.7 Informimi dhe Promovimi 26
    5.8 Bashkëpunimi Ndërkombëtar 31
    5.9 Bashkëpunimi Bilateral dhe Multilateral 32
    5.10 Caktimi i Zyrtarit Mbrojtës 34
    5.11 Regjistrimi i Dosjeve dhe Vëzhgimi me Kamerë 36
        5.11.1 Regjistrimi i Dosjeve 36
        5.11.2 Vëzhgimi me Kamerë 36
    5.12 Financat dhe Buxheti - Aktivitetet nga ndarja buxhetore janar-dhjetor 2012 38
    5.13 Shpenzimet Buxhetore 38
6. Vlerësimet e Përgjithshme dhe Rekomandimet për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 41

1. HYRJE

Në funksion të zhvillimeve të reja të teknologjisë dhe industrializimit të shpejtë të shoqërisë njerëzore, e veçmas teknologjisë së informimit e të telekomunikacionit, jeta e njeriut ka ndryshuar në kuptimin pozitiv për shpejtësinë dhe cilësinë e komunikimit në mes njerëzve në çdo pjesë të rruzullit tokësor. Ky zhvillim i shpejtë ndikoi që ndërhyrja në jetën private të njeriut të jetë e paevitueshme. Andaj duke qenë në mbështetje të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të OKB-së, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të Konventës 108 te vitit 1981 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Privatësisë gjatë përpunimit automatik të të dhënave personale, Direktivës 95/46 të vitit 1995 e drejta për mbrojtje të të dhënave personale dhe privatësisë është e drejtë themelore në kuadër të drejtave të njeriut, që është e domosdoshme për funksionimin e një shoqërie demokratike. Për më tepër, kjo e drejtë mbrohet me Kushtetutë dhe Ligjin për Mbrojtje të të Dhënave Personale edhe ne Republikën e Kosovës.

Në harmoni me nenin 44 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia me anë të këtij raporti paraqet para Kuvendit të Republikës së Kosovës një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj mbi zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në vitin 2012 si dhe jep vlerësimet dhe rekomandimet lidhur me të.

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kuvendi i Republikës së Kosovës pas propozimit të qeverisë, më 23 qershor 2011 aprovoi vendimin për caktimin e këshillit mbikëqyrës shtetëror në përbërje nga mbikëqyrësi kryesor shtetëror dhe katër mbikëqyrës shtetërorë.

Agjencia, përkundër vështirësive materiale teknike, kapaciteteve të kufizuara njerëzore dhe përvojës relativisht të vogël, tani më është në rrugë të mbarë drejt opercionalizimit të plotë për kryerjen e detyrave dhe obligimeve që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e te Dhënave Personale.

Për herë të parë Kosova i është bashkëngjitur familjes së madhe evropiane në festimin e 28 janarit, ditës së privatësisë, ku dhe ne me agjencitë simotra kemi shënuar këtë ditë me aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me Zyrën Ndërlidhëse Evropiane dhe shoqërinë civile.

Gjithashtu, me sukses kemi organizuar fushatën me qëllim të caktimit të zyrtarëve të brendshëm për mbrojtjen e të dhënave personale nga ana e organeve publike dhe private. Me këtë rast kemi drejtuar me dhjetra shkresa dhe shumë takime ku kemi sqaruar rëndësinë e caktimit të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave. Kjo ka rezultuar me caktimin e këtij zyrtari nga një numër konsiderueshëm nga ana e organeve publike qendrore. Ne në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike, kemi organizuar trajnimin e këtyre zyrtarëve.

Me qëllim të zbatimit të ligjit në kuadër të kompetencave, Agjencia ka kryer inspektimet në harmoni me planin e punës, si dhe duke vepruar në çdo rast kur është vënë re shkelje e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për herë të parë Agjencia ka pranuar ankesa të qytetarëve të cilat janë trajtuar me seriozitet dhe profesionalizëm në kuadër të kapaciteteve ekzistuese.

Viti 2012 në harmoni me planin e punës, si fokus qenësor Agjencia ka pasur ndërgjegjësimin e organeve publike dhe private për zbatimin e ligjit. Me qëllim të arritjes së këtij objektivi Agjencia ka dhënë me dhjetra seminare, punëtori dhe këshilla për organet publike dhe private.

Me qëllim të ngritjes së ndërgjegjësimit të qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë, Agjencia ka botuar disa broshura, ka qenë e pranishme në mediumet e shkruara dhe elektronike, por në pamundësi të mjeteve financiare nuk ka arritur të realizojë nivelin e kënaqshëm të ndërgjegjësimit të qytetarëve, gjë që do ta ketë si objektiv kryesor të vitit 2013.

2. KORNIZA LIGJORE

Në Republikën e Kosovës e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale dhe e privatësisë është e drejtë e garantuar me Kushtetutë, sipas marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kjo e drejtë e garantuar me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përfshinë respektimin e jetës private dhe familjare, pacenueshmërinë e banesës, fshehtësinë e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, zbatimi i drejtpërdrejtë i të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohet me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, siç janë:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

dhe Protokollet e saj;

Në vitin 2010, Kuvendi i Kosovës aprovoi Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (03/L-172) i cili përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe themeloi institucionin që është përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 22, pika 2 është ratifikuar Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve të saj, ku me nenin 8 respektohet e drejta e privatësisë dhe jetës familjare.

Gjithashtu, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë drejtpërdrejt të aplikueshme, që bartë në vete interpretimet dhe ndryshimet e legjislacionit primar dhe sekondar.

Konventat dhe direktivat evropiane, të cilat rregullojnë fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë janë: Konventa 108/EC dhe protokollet shtesë (për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale); Direktiva 95/46/EC; Direktiva 2002/58/EC (e-privatësia dhe komunikimet elektronike); Direktiva 2006/24/EC. Konventat lartcekura ende nuk janë të ratifikuara nga ana e Kuvendit të Kosovës por që duhet të ratifikohen në të ardhmen.

I gjithë legjislacioni primar dhe sekondar i cili rregullon përpunimin e të dhënave personale duhet të jetë në harmoni me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kuadër të kësaj duhet potencuar se jo të gjitha ligjet e proceduara dhe të aprovuara kanë arritur për konsultim tek Agjencia Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ne mbesim të përkushtuar të të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të jenë në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konventat dhe direktivat të cilat rregullojnë përpunimin e të dhënave personale në mbrojtjen e privatësisë.

3. PËRGJEGJËSITË DHE AUTORIZIMET

3.1 Përgjegjësitë

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucion shtetëror i pavarur i themeluar në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale. Agjencia kryesohet nga këshilli, i cili përbëhet nga mbikëqyrësi kryesor shtetëror dhe katër mbikëqyrës shtetëror, të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

Agjencia këshillon Kuvendin e Kosovës, Qeverinë, organet e pushtetit lokal, organet e tjera shtetërore, ushtruesit e pushtetit publik si dhe institucionet private për të gjitha çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse.

Propozon dhe promovon përmirësimin e mbrojtjes së të dhënave personale; Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës duhet ta informojnë Agjencinë me rastin e hartimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale.

Agjencia vendosë lidhur me ankesat e personave nëse ai ose ajo konsiderojnë se e drejta e tyre për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur, dhe informon ankuesin lidhur me rezultatin dhe masat e ndërmarra; Jep pëlqimin lidhur me krijimin e sistemit të dosjeve si dhe krijon dhe mirëmbanë regjistrin e sistemit të dosjeve; Mbikëqyrë procedurat dhe masat e duhura organizative, teknike dhe logjiko-teknike për sigurimin e të dhënave personale; Kryen inspektime dhe kontrolle për

të mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe të cilido ligj apo rregullore që rregullon përpunimin e të dhënave personale.

Agjencia bashkëpunon me organet shtetërore, ndërkombëtare dhe organet e Bashkimit Evropian lidhur me çështjet që konsiderohen të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale; Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave lidhur me transferimin e të dhënave; Parashtron kërkesë te Gjykata Kushtetuese e Kosovës për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera kur konsideron se ato nuk janë në harmoni me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave, siç parashihet në nenin 36 të Kushtetutës së Kosovës; Përpilon planin vjetor të punës si dhe paraqet para Kuvendit raportin vjetor të punës në lidhje me zhvillimet, vlerësimet dhe rekomandimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave, si dhe të njëjtin e bën publik; Ja propozon Kuvendit buxhetin për nevojat vjetore të Agjencisë; Nxjerr akte nënligjore me qëllim të zbatimit të ligjit.

3.2 Autorizimet

Me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore, Agjencia kryen inspektime dhe kontrolle. Inspektimet dhe kontrollet realizohen vetëm nga mbikëqyrësit shtetërorë. Mbikëqyrësit kryejnë inspektime dhe kontrolle të rregullta, në bazë të detyrës zyrtare si dhe sipas ankesës. Në këtë kuadër mbikëqyrësit shtetërorë kanë të drejtë të kontrollojnë dhe konfiskojnë çdo dokumentacion që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tij; kontrollojnë përmbajtjen e sistemeve të dosjeve, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tyre dhe katalogët e sistemeve të dosjeve; kontrollojnë çdo dokumentacion dhe udhëzim që rregullon sigurinë e të dhënave personale; kontrollojnë ndërtesën në të cilën të dhënat personale përpunohen dhe kanë të drejtë të kontrollojnë dhe nëse konstatohen shkelje ligjore të konfiskojnë kompjuterët dhe çfarëdo pajisje tjetër, si dhe dokumentacionin teknik; verifikojnë masat dhe procedurat që kanë për qëllim sigurimin e të dhënat personale dhe zbatimin e tyre; kryejnë çdo detyrë tjetër që konsiderohet e rëndësishme për kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve të parapara me këtë ligj.

Nëse gjatë inspektimit dhe kontrollit, mbikëqyrësi vëren shkelje të këtij ligji ose të cilido ligj apo rregullore që rregullon përpunimin e të dhënave personale, ka të drejtë që menjëherë të urdhërojë eliminimin e parregullsive ose mangësive që ai ose ajo i vë re në mënyrën dhe brenda afatit të caktuar. Kjo mund të përfshijë asgjësimin, bllokimin, shkatërrimin, fshirjen ose anonimizimin e të dhënave personale në pajtim me ligjin; të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit në sektorët publik ose privat, të cilët kanë dështuar në zbatimin e masave dhe procedurave të nevojshme për sigurimin e të dhënave personale; të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale, anonimizimin e tyre, klasifikimin dhe bllokimin e të dhënave personale sa herë që ai ose ajo vjen në përfundim se të dhënat personale janë duke u përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore; të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin/transferimin e të dhënave personale në vendet e tjera dhe organizatat

ndërkombëtare, ose zbulimin e tyre marrësve të huaj nëse ato janë transferuar ose zbuluar në kundërshtim me dispozitat ligjore ose me marrëveshjet ndërkombëtare; të paralajmërojë ose këshillojë me shkrim kontrolluesin e të dhënave ose përpunuesin e të dhënave në rastet e shkeljeve të vogla; në rast të parregullsive ose mangësive kontrolluesi i të dhënave ose përpunuesi i të dhënave duhet që menjëherë t'i korrigjojë ato pas marrjes së udhëzimeve me shkrim ose këshillimit nga Mbikëqyrësi për të siguruar përpunim të ligjshëm të të dhënave.

Në rastin e shkeljeve të dispozitave të këtij ligji nga ana e personave juridik dhe fizik, mund të dënohen për kundërvajtje me gjobë prej 200€ deri më 10,000€.

Kundër vendimit përfundimtar të mbikëqyrësit nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.

Mbikëqyrësit janë të obliguar që të mbrojnë fshehtësinë e të dhënave personale që hasin gjatë kryerjes së detyrave së tyre, si dhe pas ndërprerjes së ushtrimit të detyrave të tyre.

3.3 Misioni

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke pasur status të pavarur, ka përgjegjësinë ligjore për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale.

Këshilldhënia organeve publike dhe private, marrja e vendimeve për ankesat e paraqitura, inspektimet dhe kontrollet, informimi i publikut, si dhe promovimi e përkrahja e të drejtave themelore për mbrojtjen e të dhënave personale janë pjesë e fushë veprimtarisë kryesore në kuadër të misionit të Agjencisë.

Me ndërmarrjen e këtyre aktiviteteve, Agjencia synon që e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale dhe e privatësisë të çdo qytetari në Republikën e Kosovës të mbrohet dhe promovohet.

Me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë, Bashkëpunimi ndërkombëtar është pjesë e rëndësishme e misionit të përhershëm të Agjencisë. Duke kontribuar kështu në integrimet regjionale dhe Evropiane.

3.4 Vizioni

Me qëllim të përmbushjes së misionit të saj në periudhë afatmesme, Agjencia synon të realizojë këto objektiva:

- Harmonizimin e plotë të kornizës ligjore me EU Acquis Communautaire;
- Ndërgjegjësimin i qytetarëve për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë,
- Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave përmes inspektimeve dhe kontrolleve;

- Thellimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punëve me organet dhe institucionet tjera, si dhe me mekanizmat dhe institucionet ndërkombëtare, me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë;
- Ngritjen e profesionalizmit për stafin e Agjencisë, funksionalizimi i plotë i strukturës organizative si dhe sigurimi i hapësirave të punës në objekte shtetërore;
- Fushatën njoftuese dhe ndërgjegjësuese për opinionin publik përmes aktiviteteve përkatëse;
- Mbajtjen e takimeve, konferencave dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me karakter rajonal dhe ndërkombëtar;
- Regjistrimin e të gjitha dosjeve të institucioneve publike dhe private.

3.5 Aktet Nënligjore të Agjencisë

Në harmoni me nenin 47, 93 dhe 94 të Ligjit Nr.03 /L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim të zbatimit të ligjit, Agjencia ka nxjerrë akte nënligjore dhe dokumentet përcjellëse administrative.

3.5.1 Akte Nënligjore

- Rregullorja e Punës së Agjencisë;
- Udhëzimi Administrativ nr. 03/2012 për Kartelat Zyrtare të Mbikëqyrësve Shtetërorë;
- Rregullorja nr. 01/2012 për Mënyrën e Kryerjes së Inspektimit dhe Kontrollit;
- Rregullorja nr. 02/2012 për Mënyrën e Mbajtjes së Regjistrit të Sistemeve të Dosjeve të të Dhënave Personale dhe Formularit Përkatës;
- Rregullorja nr. 03/2012 mbi Procedurën e Brendshme të Shqyrtimit të Kërkesave për Lejimin e Transferimit Ndërkombëtar të të Dhënave Personale;
- Udhëzimi Administrativ nr. 01/2011 për Caktimin e Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Kodi i Etikës për Punonjësit e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

3.5.2 Dokumente Administrative:

- Lista e Kontrollit
- Formulari i Ankesës
- Procedurat e Trajtimit të Ankesës
- Formulari i Procesverbalit të Inspektim-Kontrollit
- Formulari Kërkesë për Marrjen e Autorizimit për Transferim të të Dhënave Personale.
- Formulari Kërkesë për Regjistrimin e Sistemit të Dosjeve.

4. RAPORTI I PROGRESIT - LIBERALIZIMI I VIZAVE

Në kuadër të shqetësimeve të ngritura si në raportet e progresit apo në vlerësimin e BE për liberazimin e vizave – ASHMDHP ka kryer të gjitha detyrat të cilat i janë adresuar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në harmoni me detyrat e obligimet e dala nga Raporti i Progresit, Agjencia ka nxjerrë Kodin e Etikës, si dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Agjencinë Antikorrupsion, është organizuar trajnimi i rreth 700 zyrtarëve të ARC-së në fushën e etikës së mirësjelljes, mbrojtjes së të dhënave dhe luftës kundër korrupsionit.

Agjencia, me qëllim të harmonizimit të plotë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me legjislacionin e BE (*Acquis Communautaire)*, në bashkëpunim me ekspertët e TAIEX-it, ka draftuar amandamentimin e ligjit, i cili është në procedurë të rregullt për tu aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në pjesën e parë të vitit 2013.

Ne mbesim të përkushtuar në plotësimin e të gjitha detyrave të nevojshme, të cilat dalin nga dokumentet e Bashkimit Evropian, qoftë të raportit të progresit apo të liberalizimit të vizave.

Në të gjitha raportet vlerësuese të BE-së, Agjencia është vlerësuar lart për përkushtimin dhe përmbushjen e të gjitha rekomandimeve. Në të njëjtat raporte kërkohet dhe rekomandohet që Agjencia të ketë kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe financiare për të realizuar misionin e saj.

Në bashkëpunim me projektin e IPA-së synojmë të rishikojmë të gjithë legjislacionin vendor dhe të propozojmë harmonizimin e plotë të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konventat dhe direktivat të cilat rregullojnë përpunimin e të dhënave personale në mbrojtjen e privatësisë, e cila është një ndër detyrat primare në rrugëtimin tonë drejtë BE-së.

5. AKTIVITETET E AGJENCISË NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

5.1 Organizimi i Agjencisë

Organet e Agjencisë janë Këshilli dhe Departamentet.

5.1.1 Këshilli

Agjencia kryesohet nga Këshilli pesë anëtarësh të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

Këshilli përbëhet nga mbikëqyrësi kryesor shtetëror dhe katër mbikëqyrës shtetërorë, ku njëri prej tyre emërohet nga mbikëqyrësi kryesor në cilësinë e zëvendësit të mbikëqyrësit kryesor shtetëror.

Këshilli, gjatë vitit 2012 ka mbajtur trembëdhjetë mbledhje dhe ka nxjerrë tridhjetedy vendime.

5.1.2 Departamentet

Departamentet e kryejnë punën e tyre ne përputhje të obligimeve që dalin nga Ligji 03/L-172; Rregullorja e Punës së Agjencisë dhe legjislacionit në fuqi, në mbështetje të punës së Këshillit.

Për kryerjen e punëve profesionale dhe administrative, fushëveprimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin në fuqi; Agjencia punën e vet e ka të organizuar përmes departamenteve në këto dy fusha:

- Fusha e Administratës
- Fusha Profesionale - Operacionale

Personeli i punësuar është i obliguar që të mbrojë fshehtësinë e të dhënave personale që hasin gjatë kryerjes së detyrave të tyre, si dhe pas ndërprerjes së ushtrimit të tyre.
Personeli i punësuar në Agjenci, gjatë ushtrimit të kompetencave dhe autorizimeve ligjore, duhet të jetë transparent, profesional, efikas dhe efektiv, i pavarur, i paanshëm dhe nuk mund ushtrojë asnjë veprimtari politike.
Në bazë të buxhetit të ndarë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Agjencia ka të lejuar një staf prej njëzet zyrtarëve, pesë nga të cilët janë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Numri i vogël i personelit të lejuar paraqet sfidë në realizimin e detyrave dhe obligimeve që dalin nga legjislacioni në fuqi, në sektorin shtetëror dhe atë private.

Që nga koha e themelimit - qershor 2011, Agjencia posedon një buxhet jashtëzakonisht restriktiv, numër të vogël të lejuar të personelit, për këtë arsye nuk janë funksionalizuar plotësisht ose nuk janë formësuar departamentet e parapara me strukturë organizative.

Përkundër kësaj, Agjencia për këtë kohë ka arritur në një masë të konsolidojë personelin profesional, duke qenë në përkushtim të vazhdueshëm për krijimin e një strukture me staf kompetent, dhe profesionalisht të përgatitur me tendencën e vetme krijimin e një administrate efikase dhe profesionalisht të qëndrueshme.

Si shkak i numrit të vogël të personelit, zyrtarët janë të angazhuar deri në pesë funksione, duke arritur edhe certifikimin ne pjesën e shpenzimeve ku vlenë te ceket se në vitin 2013 janë të certifikuar të gjithë zyrtarët që i parasheh ligji i financave dhe manuali i thesarit, përveç zyrtarit të prokurimit.

Agjencia, gjatë vitit 2012 ka kryer procedurat e shpenzimeve përmes kapaciteteve njerëzore të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit	Nr aktual i punëtorëve në fillim të 2012		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2012	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Funksionar publik	**5**	**5**		**5**	
Admini. Qemdrore	15	10		12	
Total	20	15		17	

5.2 Këshilla dhe Opinione

Agjencia ka dhënë këshilla dhe opinione institucioneve publike dhe private për të gjitha çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë edhe interpretimin dhe zbatimin e ligjit dhe të gjitha ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë përpunimin e të dhënave personale.

Gjatë kësaj periudhe, Agjencia ka dhënë dy opinione, për:

- **Avokatin e Popullit - Qasjen në faturat e zyrtareve të lartë shtetërorë**

Agjencia ka pranuar një kërkesë nga Avokati i Popullit të bazuar në ligjin për qasje në dokumentet publike, në lidhje me atë se nëse qasja në faturat e shpenzimeve prekë të dhënat personale të ndjeshme dhe privatësinë e kryeministrit dhe zv. kryeministrave dhe se a mund të publikohen faturat e shpenzimeve të kësaj natyre.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe duke u bazuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale Agjencia ka dhënë mendim se faturat përmbajnë të dhëna të cilat sipas nenit 2 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë të dhëna personale. Këto të dhëna lidhen me mënyrën e jetesës së zyrtarëve të lartë shtetëror, dhe mund të identifikohen përmes këtyre të dhënave. Zyrtarët e Lartë Shtetëror janë fokus i këtyre të dhënave, dhe zbulimi i faturave ndikon drejtpërdrejt në privatësinë e tyre, kapacitetin e tyre personal ashtu edhe profesional. Publikimi i faturave për shkak të ndjeshmërisë së informacionit të cilët përmbajnë do të shkel privatësinë e zyrtarëve të lartë shtetëror.

Zbulimi i këtyre të dhënave do të ishte në kundërshtim me nenin 36 dhe 41 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 12 (1.6) të Ligjit 03/L-215 për qasjen në dokumente publike, me nenin 3 (1), nenin 5 (1.1), nenin 7 (1), nenin 9(2) dhe neni 10 (2) të ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Duke e pasur parasysh interesin publik sa i përket njohurisë apo të drejtës për të ditur për shfrytëzimin e parasë publike, të dhënat nga faturat mund të publikohen duke përjashtuar ose anonimizuar të dhënat lartcekura. Në pamundësi të anonimizimin të tyre të krijohet një formular (apo formë e përshtatshme) i cili do të ofronte transparencën e nevojshme të shpenzimeve të parasë publike.

- **KK Lipjan - Qasjen në listat e pagave të nëpunësve civilë**

Agjencia ka pranuar një kërkesë nga KK Lipjan të bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike në lidhje me atë se nëse dhënia e kopjeve të listave të pagave për periudhën dhjetor 2009 - gusht 2012 një OJQ- je do të ishte në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia ka dhënë mendim se dhënia e kopjeve të dokumenteve të lartcekura do të ishte në kundërshtim me ligjin.

Në kuadër të përgjegjësive, mbikëqyrësit shtetërorë, gjatë këtij viti kanë dhënë 29 këshilla institucioneve të ndryshme, kryesisht të natyrave mbi transferimin e të dhënave personale dhe marketingun e drejtpërdrejtë, zbulimin e të dhënave, qasje në të dhëna etj.

Institucione të cilat kanë kërkuar këshilla nga Agjencia në lidhje me çështje e lartcekura janë:

- Avokati i Popullit
- Zyra e Kryeministrit,

- Ministria e Integrimeve
- Ministria e Administratës Publike,
- Agjencia e Regjistrimit Civil,
- Agjencia Kadastrale e Kosovës,
- Agjencia Kosovare e Privatizimit,
- Autoriteti Tatimor i Kosovës
- Banka Qendrore e Kosovës,
- Trusti Pensional i Kosovës,
- Dogana,
- Bankat ,
- Kompanitë e Sigurimeve,
- Kompanitë e Sigurimit Fizik
- Operatori i Telefonisë PTK – Vala,
- Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese BIRN-i
- Televizioni Kohavizion
- RTV 21

Disa nga këshillat që janë dhënë nga mbikëqyrësit shtetërorë, ballafaqohen një numër i madh i institucioneve dhe këto këshilla mundë të vlejnë për të gjithë përpunuesit e të dhënave. Kështu, gjatë kësaj periudhe Agjencia ka nxjerrë vendime këshilluese për:

- **Doganën e Kosovës - Publikimi i aktvendimeve**

Agjencia ka pranuar një kërkesë nga Dogana e Kosovës për dhënien e mendimit nëse publikimi i akt- vendimeve në portalin zyrtar të Doganës është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia ka dhënë mendim se aktvendimet që nxjerr Dogana, mund të publikohen në portalin e saj zyrtar vetëm nëse anonimizohen të dhënat personale të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë bëjnë të identifikueshëm personat fizikë që trajton aktvendimi.

- **Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës - Qasja në pasqyrën e llogarisë së pensioneve nga të afërmit e klientit**

Agjencia ka pranuar një kërkesë nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës për dhënien e mendimit nëse qasja në pasqyrën e llogarisë së pensioneve nga të afërmit e klientit është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia ka dhënë mendim se qasja në pasqyrat e llogarisë individuale të pensionit nga të afërmit është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- **Agjencia e Regjistrimit Civil MPB – Qasja në të dhënat e pronarëve të automjeteve**

Agjencia ka pranuar disa kërkesa për dhënien e mendimit lidhur me zbulimi i të dhënave të pronarëve të automjeteve.
Pas shqyrtimit te kërkesave, në një rast është lejuar zbulimi e të dhënave statistikore të automjeteve të regjistruar duke i pamundësuar kërkuesit qasje të pjesshme në të dhënat e kërkuara.
Lidhur me kërkesën për qasje në të dhënat e pronarëve të automjeteve që janë regjistruar gjatë një vit kalendarik është konstatuar se zbulimi i këtyre të dhënave është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Agjencia e Regjistrit Civil është këshilluar që kërkuesit ti ofrojë të dhënat statistikore në harmoni me kërkesën duke anonimizuar të dhënat personale.

Lidhur me kërkesën për zbulimi e të dhënave personale të pronarit të automjetit duke iu referuar tabelave të regjistrimit të automjetit është konstatuar se zbulimi i të dhënave të kërkuara mund të jetë i lejueshëm vetëm në rastet kur është interesi i madh publik, dhe të dhënat e zbuluara nuk do të mundësojnë zbulimin e përkatësisë politike, fetare, anëtarësinë në ndonjë sindikatë, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual, të subjektit të cilit do ti zbulohen të dhënat. Gjithashtu, të dhënat e zbuluara nuk mund të përdoren për qëllime denigrimi, propagandistike dhe komerciale.

- **Agjencia Kadastrale e Kosovës - Qasja në të dhënat e pronarëve të pronave**

Agjencia ka pranuar një kërkesë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës për dhënien e mendimit nëse zbulimi i të dhënave të pronarëve të pronave është në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia ka dhënë mendim se zbulimi i të dhënave të lartcekura mund të bëhet nëse vlerësohet se është në interes të publikut, dhe atëherë mund të zbulohen emri i pronarit, lokacioni dhe prona.

- **Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë – Publikimi i proçesverbalit lidhur me shpenzimin e energjise elektrike**

Agjencia ka pranuar një kërkesë nga Rjeti Ballkanik i Gazetarisë -BIRN (gazatarja e këtij rrjeti z. D. D.) dhe ka kërkuar të interpretohet ky rast; nëse është e shkelur e drejta e konsumatorit për të dhënat e tij private, ku bëhet fjalë për një procesverbal të hartuar nga ana e Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës (i cili ishte gjetur nga BIRN-i) lidhur me shpenzimet e energjisë elektrike.

Pas shqyrtimit të kësaj kërkese, në përputhje me Ligjin 03/L-172, Agjencia ka dhënë mendimin e vet se:

Të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme dhe të ligjshme pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave.

Të dhënat personale grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime, përveç nëse nuk është e paraparë ndryshe me ligj. Ndërsa për sigurimin e të dhënave nga ana e institucionit (në këtë rast KEK-ut), të dhënat personale duhet të jenë të mbrojtura, dhe të parandalohet çfarëdo shkatërrimi i qëllimshëm dhe i paautorizuar dhe të njëjtat ruhen deri te arritja e qëllimit për çka janë grumbulluar dhe për çka subjekti ka dhënë pëlqimin e tij për realizimin e interesave të tij konform legjislacionit specifik (në këtë rast ligji mbi energjinë elektrike).

Konsultim me Rastin e Hartimit të Masave Legjislative dhe Administrative

Në bazë të nenit 39 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku thuhet se Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës duhet ta informojnë Agjencinë me rastin e hartimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë vitit 2012 ka shqyrtuar dhe ka dhënë mendimin për këto akte të cilat kanë ardhur për komentim nga institucionet:

5.2.1 Projekt – Ligje

- Projektligjin për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-016 për Ushqim.
- Projektligjin për Plotësim dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.03/L -064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës.

- Projektligjin për Trashëgiminë Kulturore.
- Projekt Ligjin për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme.

5.2.2 Projekt – Rregullore

- Rregulloren për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.
- Projekt-rregullore për Planifikimin e Trajnimeve dhe Koordinimin e Donacioneve për Trajnimet e Institucioneve të Sigurisë Publike të cilat organizohen dhe mbahen në AKSP.
- Projekt-rregulloren për Ofrimin e Trajnimeve dhe Shërbimeve për Personat Privat Fizik dhe Juridik.
- Rregulloren për Kriteret dhe Mënyrën e Ndarjes së Çmimit Vjetor të Diasporës dhe Mërgatës për Grupin apo Mërgimtarin më të suksesshëm gjatë vitit;
- Projekt- rregulloren për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.
- Projekt-rregulloren për Kodin e Etikës në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;
- Projekt-rregullore për Implementimin e Standardit për Klasifikimin e Veprimtarive Ekonomike në Versionin NACE-Rev.2.
- Projekt - Rregulloren mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.

5.2.3 Projekt - Udhëzime Administrative

- Udhëzimin Administrativ për Lëshimin e Vizave në Pikat e Kalimit Kufitar.
- Udhëzimin Administrativ për Sistemin Informativ Ujor.
- Udhëzimin Administrativ për Menaxhimin e Mbeturinave nga Industria Minierave dhe Minierave.

5.2.4 Draft-Marrëveshje

- Draft-marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Ndihmë të Ndërsjellët Juridike në Çështjet Penale.

5.3 Ankesat

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person i cili konsideron se i është shkelur e drejta e tij ose e saj në privatësi në kuptim të të dhënave personale, mund të parashtrojë ankesë në Agjenci. Ankesat mund të parashtrohen gojarisht përmes telefonit, me shkrim ose

me mjete elektronike përmes e-mailit. Pas shqyrtimit të ankesës, Agjencia informon ankuesin lidhur me rezultatin dhe veprimet e ndërmarra.

Agjencia, gjatë vitit 2012 ka pranuar gjithsej 16 ankesa, të cilat janë trajtuar në harmoni me procedurat dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Duke u marrë me këtë rast dhe veprimet e nevojshme për shqyrtimin e ankesave si inspektimet dhe kontrollet dhe kontaktet me kontrollorët të cilët kanë qenë subjekt i ankesës.

Kryesisht qytetarët e Republikës së Kosovës janë ankuar për keqpërdorimin e të dhënave personale nga ana e kontrollorëve ku të dhënat e tyre janë keqpërdorur me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë, zbulimit të paautorizuar të të dhënave, përpunimi i të dhënave pa pëlqimin e subjektit si dhe përpunimi i të dhënave jo të sakta.

Këto ankesa kanë qenë kryesisht të orientuara ndaj sektorit bankar, sektorit mikrofinanciar, Dogana, operatorët e telefonisë mobile dhe KEK-ut.

Numri i vogël i ankesave gjatë viti 2012 është tregues se qytetarët e Republikës së Kosovës kanë nevojë edhe më shumë të jenë të informuar lidhur me të drejtat e tyre në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë.

Ne mbesim të përkushtuar që gjatë vitit 2013 të fokusohemi në ndërgjegjësimin e qytetarëve për të drejtat e tyre. Në kuadër të krijimit të lehtësive që qytetarët të kenë mundësi të ankohen, Agjencia ka mundësuar që formulari për ankesë të shkarkohet nga faqja zyrtare dhe e njëjta të dërgohet përmes postës elektronike.

5.4 Inspektimi dhe Kontrolli

Agjencia bën mbikëqyrjen e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, i cili bëhet përmes inspektimeve dhe kontrolleve. Agjencia kryen inspektime të rregullta sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të ankesave.

Agjencia ka kompletuar tërë kornizën e nevojshme për realizimin e inspektimeve dhe kontrolleve. Në kuadër të kësaj, Agjencia ka nxjerrë rregulloren për inspektim, listën e kontrollit dhe formularin e procesverbalit.

Përkundër përvojës relativisht të vogël, Agjencia gjatë vitit 2012, ka kryer 48 inspektime të rregullta në bazë të planit të punës dhe planit të inspektimit të aprovuar nga ana e Këshillit.

Inspektimet kanë pasur këtë shtrirje gjatë vitit 2012:

- Organet publike qendrore 19
- Organet publike lokale 6
- Organet private 23





Sipas llojit të inspektimeve kemi këtë gjendje:

- Inspektime të rregullta 37
- Inspektime sipas ankesës 4
- Inspektime sipas detyrës zyrtare 7

Nga 37 inspektime të rregullta, trembëdhjetë nga këto kanë qenë inspektime të përgjithshme dhe 26 në fusha të caktuara.

5.4.1 Inspektime të Përgjithshme

Në kuadër të inspektimit të përgjithshëm janë mbikëqyrur procedurat e përpunimit të të dhënave, siguria e të dhënave, sistemi i dosjeve, transferimi i të dhënave, marketingu i drejtpërdrejtë, vëzhgimi me kamerë, karakteristikat biometrike, regjistrimet e hyrjes dhe daljes nga ndërtesa, ndërlidhje e sistemeve, realizimi i të drejtës se subjektit të të dhënave personale, zyrtari i brendshëm i mbrojtjes së të dhënave personale.

Inspektime të përgjithshme janë realizuar në institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Integrimeve Evropiane
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Kuvendi i Kosovës
- Instituti i Kosovës për Administratë Publike
- Agjencia Qendrore e Prokurimit
- ZKM – Agjencia e Barazisë Gjinore
- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil
- Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
- Kuvendi Komunal Novobërdë
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- Zyrat Konsullore të Republikës së Kosovës në Zvicër (3)

Institucionet e lartcekura kryesisht nuk janë përpunues të mëdhenj të të dhënave personale. Ato kryesisht përpunojnë të dhënat personale të stafit të tyre. Gjatë inspektimit janë gjetur parregullësi të vogla, si mosnënshkrimi i deklaratës së konfidencialitetit nga ana e nëpunësve që përpunojnë të dhëna personale si dhe mosmbajtja e listës së nëpunësve që për shkak të natyrës së punës kanë qasje në të dhënat personale.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale këto parregullsi janë të vogla, me ç'rast Agjencia ka marrë vendim që institucionet të këshillohen për eliminimin e këtyre parregullsive, të cilat këshilla janë zbatuar në tërësi.

Inspektime të rregullta në fushën e vëzhgimit me kamerë dhe regjistrimet e hyrjes dhe daljes në ndërtesa janë realizuar në 25 institucionet e mëposhtme:

1. Ministria për Forcën e Sigurisë
2. Ministria e Arsimit
3. Ministria e Infrastrukturës
4. Ministria e Drejtësisë
5. Autoriteti i Aviacionit Civil
6. N.Sh. Stacioni i Autobusëve Prishtinë
7. Kuvendi Komunal i Prishtinës
8. Kuvendi Komunal i Podujevës
9. Hotel EMERALD
10. Hotel AFA
11. Hotel PRISHTINA
12. Hotel NARTEL
13. Hotel ROYAL
14. Kolegji FAMA
15. Kolegji ILIRIA
16. Kolegji BIZNESI
17. Kolegji UBT
18. Kolegji DARDANIA
19. Kolegji UNIVERZUM
20. Kolegji VICTORY
21. Institucioni i Arsimit të Lartë AAB
22. Qendra Tregtare ETC
23. Qendra Tregtare Grand Store
24. Qendra Tregtare Albi MAll

Gjatë inspektimeve të organeve publike dhe private në fushat e lartcekura janë konstatuar parregullsi të vogla, për të cilat Agjencia, në bazë të të gjeturave, ka nxjerrë disa vendime, me anë të cilave organet përkatëse këshillohen për eliminimin e parregullsive të konstatuara. Agjencia ka bërë kontrolle tek organet e lartcekura për të verifikuar zbatimin e vendimeve. Gjë që ka rezultuar se të gjitha organet të cilat u janë nënshtruar inspektimeve kanë zbatuar plotësisht vendimet e nxjerra nga ana e Agjencisë. Është vënë re një përkushtim i theksuar nga

ana e sektorit privat për të zbatuar Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale që ka rezultuar me takime të shpeshta dhe konsulta të shumta.

Agjencia, në bazë të vlerësimeve paraprake, konstaton tendencën e organeve publike dhe private për mbikëqyrjen e gjerë të hapësirave me ndihmën e vëzhgimit me kamerë. Jo rrallë qëllimi i vendosjes së vëzhgimit me kamerë bie ndesh me dispozitat ligjore të cilat definojnë qartë se për cilat qëllime mund të vendoset vëzhgimi me kamerë dhe cilat janë hapësirat të cilat mund të vëzhgohen me kamerë.

Pavarësisht aplikimit në masë të madhe të sistemit të vëzhgimit me kamerë në nivel vendi, mund të konstatojmë se organet publike dhe private në masë të kënaqshme janë duke respektuar dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë vëzhgimin e ligjshëm me kamerë. Gjë që mund të vërehet me numrin e madh të njoftimeve të standardizuara të vendosur nga organet publike dhe private në të gjitha rastet ku është duke u aplikuar vëzhgimi me kamerë.

5.4.2 Inspektimet Sipas Ankesës

Agjencia, gjatë vitit 2012, pas analizimit dhe vlerësimit të ankesave ka realizuar katër inspektime. Me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të ankuesve, janë realizuar inspektimet dhe kontrollet në institucionet e mëposhtme:

- Banka TEB (2)
- Banka ProCredit
- Institucioni Mikrofinanciar BZMF

Ankesat kanë qenë kryesisht të fushave të marketingut të drejtpërdrejtë, saktësisë së të dhënave, zbulimit të të dhënave si dhe përdorimin e të dhënave për qëllime tjera për të cilat janë grumbulluar. Pas inspektimit të institucioneve të lartpërmendura, Agjencia ka marrë vendime përmes të cilave është urdhëruar që parregullsitë e gjetura të eliminohen, përveç në rastet kur institucioni ka qenë në harmoni me ligjin.

Në të gjitha rastet ankuesit janë njoftuar me rezultatin e inspektimit si dhe me veprimet e ndërmarra nga ana e Agjencisë brenda mandatit të saj.

Është me rëndësi të theksohet që të gjitha vendimet e Agjencisë janë zbatuar dhe kanë pasur efekte në përmirësimin e praktikave joligjore të deriatëhershme sa i përket përpunimit të të dhënave.

5.4.3 Inspektimet sipas detyrës zyrtare

Agjencia, gjatë vitit 2012 ka realizuar shtatë inspektime sipas detyrës zyrtare. Informacionet për shkeljet e mundshme të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave janë marrë kryesisht nga mediumet dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në kuadër të inspektimeve sipas detyrës zyrtare hyjnë edhe inspektimet të cilat bëhen me rastin trajtimit të kërkesave të organeve për marrjen e

autorizimeve të parapara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për secilin rast Agjencia ka realizuar inspektime në institucionet e mëposhtme për të vërtetuar nëse institucioni bënë shkelje të ligjit. Nëse gjatë përpunimit të të dhënave personale ose kërkesa për përpunimin e të dhënave personale është në harmoni me ligjin. Institucionet në të cilat janë bërë inspektime sipas detyrës zyrtare janë si më poshtë:

- ARC - Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave,
- Ansambli i Këngëve dhe i Valleve "Shota",
- QKMF Gjilan,
- QKMF Vushtrri,
- Banka TEB (2),
- Banka NLB Prishtinë,

Inspektimet sipas detyrës zyrtare janë bërë në fushat e vëzhgimit me kamerë dhe përdorimin e karakteristikave biometrike. Pas inspektimit në institucionet që kanë përdorur kamera për vëzhgim është konstatuar se i njëjti realizohet në kundërshtim me ligjin dhe si rrjedhojë Agjencia ka marrë vendim përmes të cilit urdhëron ndalimin e përdorimit të kamerave deri sa të përmbushen kriteret e përcaktuara me ligj.

Në të gjitha rastet ankuesit janë njoftuar me rezultatin e inspektimit si dhe me veprimet e ndërmarra nga ana e Agjencisë brenda mandatit të saj.

Në të gjitha rastet gjatë inspektimit në lidhje me kërkesat për përdorimin e karakteristikave biometrike është vërtetuar se nevoja për përdorimin e tyre është në harmoni me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në bazë të njoftimeve nga institucionet ndaj të cilave janë nxjerrë vendimet dhe pas kontrolleve të bëra është konstatuar se vendimet të cilat janë nxjerrë nga ana e Agjencisë për rastet e lartcekura janë respektuar nga institucionet.

5.4.4 Përpunimi i të dhënave biometrike

Në bazë të Ligjit për Mbrojtje të Dhënave Personale të dhënat biometrike konsiderohen të dhëna personale të ndjeshme dhe si të tilla ato duhet të mbrohen në mënyrë të veçantë dhe të klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe përdorimit të paautorizuar.

Sektori publik dhe privat mund ti përdorë karakteristikat biometrike vetëm nëse është e domosdoshme për sigurinë e njerëzve, sigurimin e pronës ose mbrojtjen e të dhënave konfidenciale dhe sekreteve të biznesit.

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerësimin e domosdoshmërisë së përdorimit të të dhënave biometrike e bën Agjencia përmes dhënies së autorizimit për përdorim, përveç rasteve të parapara me ligj.

Të gjitha organet publike dhe private të cilat dëshirojnë të përpunojnë të dhënat biometrike, përveç rasteve të parapara me ligj, para përdorimit të dhënave biometrike duhet marrë autorizimin nga Agjencia në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në vitin 2012 Agjencia ka pranuar dy kërkesa për marrjen e autorizimit për përdorimin e karakteristikave biometrike:

- **Banka TEB Sh.A.** ka kërkuar autorizim për përdorimin e karakteristikave biometrike për kontrollin e qasjes në dhomën e serverëve.
    - Agjencia ka shqyrtuar dokumentacionin e ofruar, ka kryer inspektimin në harmoni me procedurat e brendshme dhe ka konstatuar se janë plotësuar kriteret e parapara me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Agjencia ka nxjerrë vendimin me anën e të cilit është dhënë autorizimi për përdorimin e karakteristikave biometrike në hapësirat e lartshënuara.

- **Banka NLB Prishtina Sh.A.** ka kërkuar autorizim për përdorimin e karakteristikave biometrike për kontrollin e qasjes në hapësirat e rëndësisë së veçantë.
    - Agjencia ka shqyrtuar dokumentacionin e ofruar, ka kryer inspektimin në harmoni me procedurat e brendshme dhe ka konstatuar se janë plotësuar kriteret e parapara me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Agjencia ka nxjerrë vendimin me anën e të cilit është dhënë autorizimi për përdorimin e karakteristikave biometrike në hapësirat e lartshënuara.

5.5 Transferimi i të Dhënave

Në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, transferimi i të dhënave personale, të cilat janë përpunuar ose ato që do të përpunohen në vende të tjera apo në organizata ndërkombëtare, mund të bëhet vetëm nëse këto vende sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave. Për të gjitha ato vende apo organizata ndërkombëtare të cilat nuk sigurojnë nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave, organi publik apo privat që dëshiron të bëjë transferim të të dhënave, duhet të ndjekë procedurat e marrjes së autorizimit nga Agjencia.

Agjencia ka aprovuar legjislacionin sekondar me të cilin rregullohen procedurat e transferimit të të dhënave personale jashtë vendit. Në kuadër të këtij legjislacioni sekondar është aprovuar rregullorja mbi procedurat e brendshme të shqyrtimit të kërkesave për lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale, si dhe është aprovuar edhe formulari i cili duhet të plotësohet me rastin e kërkesës nga ana e institucionit për transferimin e të dhënave.

Me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor si dhe për të kontribuar në krijimin e lehtësive për transferimin e të dhënave, Agjencia përmes një vendimi formal, ka nxjerrë listën e vendeve që

sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale dhe për të njëjtat vende nuk kërkohet marrje e autorizimit nga ana e Agjencisë.

Lista e mëposhtme në vazhdimësi do të përditësohet me vendet dhe organizatat ndërkombëtare me nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave.

Lista e vendeve të Bashkimit Evropian të cilat sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale:

- Austri
- Belgjikë
- Britani e Madhe
- Bullgari
- Danimarkë
- Estoni
- Finlandë
- Francë
- Gjermani
- Greqi
- Holandë
- Hungari
- Irlandë
- Itali
- Letoni
- Lituani
- Luksemburg
- Maltë
- Poloni
- Portugali
- Qipro
- Republika Çeke
- Rumani
- Sllovaki
- Slloveni
- Spanjë
- Suedi

Shtetet anëtare të "Zonës Ekonomike Evropiane" të cilat sigurojnë nivel të duhur të mbrojtje së të dhënave personale:

- Islandë
- Litenshtein
- Norvegji
- Zvicër

Në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka publikuar listën në Gazetën Zyrtare dhe në faqen publike të Agjencisë.

Agjencia, në të gjitha rastet kur bën inspektime, verifikon nëse kontrolluesi bën transferim të të dhënave jashtë vendit dhe se i njëjti realizohet në përputhje me dispozitat e ligjit. Agjencia mund të ketë një pasqyrë të përgjithshme sa i përket transferimit të të dhënave personale kur të përfundojë regjistrimin e dosjeve të kontrollueseve. Ky projekt është në fazën e zbatimit në bashkëpunim me ekspertët e TAIEX.

Në vitin 2012 Agjencia ka pranuar dy kërkesa për transferimin e të dhënave personale dhe ka dhënë dy autorizime për transferimi e të dhënave personale:

- **Novo Nordisk Pharma Operations A/S Kosovo Branch** me seli në Danimarkë ka kërkuar autorizim për transferim e të dhënave personale të nëpunësve të kësaj kompanie dega në Kosovë, në kompaninë **Sayam Computer Services Limited** me seli në Indi.
    - Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga kërkuesi, Agjencia ka konstatuar se janë plotësuar kriteret e parapara në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ka lejuar autorizimin për transferimin e të dhënave personale të nëpunësve të kompanisë së lartcekur dega në Kosovë, *me përjashtim të kombësisë.*

- **Banka TEB Sh.A.** ka kërkuar autorizim për transferimin e të dhënave personale të klientëve në Turqi, konkretisht në kompanitë **Bank Soft** dhe **E-KART** me qëllim të personalizimit dhe shtypjes së kartelave bankare dhe të klientëve.
    - Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga kërkuesi, Agjencia ka konstatuar se janë plotësuar kriteret të parapara në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ka lejuar autorizimin për transferimin e të dhënave personale të klientëve në kompanitë e lartcekura.

5.6 Harmonizimi dhe Përafrimi i Legjislacionit

Harmonizimi dhe përafrimi i legjislacionit të Republikës së Kosovës me atë të BE-së (Acquis Communautaire) në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë ka qenë dhe është një ndër prioritetet e Agjencisë.

Me qëllim të harmonizimit të plotë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me direktivat evropiane, me ndihmën e ekspertëve të TAIEX-it, janë propozuar amendamentet për plotësim – ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Agjencia është në pritje të zbatimit të projektit IPA, ku një ndër objektivat është harmonizimi dhe përafrimi i gjithë legjislacionit me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

5.7 Informimi dhe Promovimi

Informimi i publikut për çështjet dhe zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave si dhe promovimi i të drejtës themelore për mbrojtjen e të dhënave personale është një ndër prioritetet dhe njëkohësisht sfidë e Agjencisë.

Në kuadër të kësaj, me qëllim të informimit dhe promovimit të të drejtave dhe obligimeve që burojnë nga ligji, në bashkëpunim me zyrën ndërlidhëse Evropiane, TAIEX-in dhe shoqërinë civile, Agjencia ka organizuar konferenca, seminare, trajnime dhe punëtori me organet publike edhe private.

Për herë të parë edhe Kosova ka shënuar 28 Janarin, duke iu bashkëngjitur familjes së madhe evropiane, e cila që nga viti 2006 shënon këtë ditë si ditën e mbrojtjes së të dhënave, me ç'rast organizohen aktivitete me qëllim të informimit dhe promovimit të të drejtave për mbrojtjen e të dhënave personale.

Agjencia, në bashkëpunim me Zyrën Ndërlidhëse Evropiane, shoqërinë civile, organet e pushtetit qëndror dhe zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave personale, me rastin e 28 Janarit - Ditës së Mbrojtjes së të Dhënave ka organizuar konferencën me temën "Sfidat në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale", me ç'rast kemi promovuar broshurën që i dedikohet kësaj dite.

Me qëllim të arritjes së promovimit të drejtave të subjekteve të dhënave, Agjencia ka organizuar trajnimin e zyrtarëve të mbrojtjes së të dhënave, ku zyrtarët janë trajnuar me qëllim të promovimit dhe të mbrojtjes të drejtave të subjekteve të dhënave. Trajnimi është organizuar edhe në bashkëpunim me IKAP-in për zyrtarë të mbrojtjes së të dhënave, ku mysafirë kanë qenë edhe përfaqësues nga Mali i Zi, të cilët kanë ndarë njohuritë dhe ekspertizën e tyre me zyrtarë të mbrojtjes së të dhënave.

Në bashkëpunim me Agjencinë e Regjistrimit Civil, Agjencinë Antikorrupsion dhe në mbështetje të Komisionit Evropian kemi mbajtur trajnim për rreth 700 zyrtarë në nivel vendi, ku janë bërë trajnime në fushën e antikorrupsionit, mbrojtjes së të dhënave personale dhe kodit të etikës. Ky aktivitet ishte organizuar për një javë rresht në dhjetor të 2012. Për vijuesit e këtij trajnimi janë shpërndarë edhe certifikata.

Ndërkaq, në bashkëpunim me OSBE-në Agjencia në muajin nëntor ka organizuar seminar ndërgjegjësues me studentët e Univeritetit të Prishtinës.

Pas organizimit të këtij trajnimi, Agjencia ka vazhduar në fazën e dytë në kuadër të planit për informim dhe promovim duke organizuar në bashkëpunim me zyrtarët e mbrojtjes së të dhënave, seminare ndërgjegjësuese në organet publike dhe private.

Agjencia, gjatë vitit 2012 ka organizuar dhe mbajtur seminare ndërgjegjësuese në organet publike dhe private.

Agjencia ka organizuar seminare ndërgjegjësuese në këto organe publike:

- Zyra e Kryeministrit
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- Dogana e Kosovës
- Administrata e Tatimore e Kosovës
- Posta dhe Telekomi i Kosovës

Deri sa në organet private, Agjencia ka organizuar seminare ndërgjegjësuese në:

- Shoqatën e Bankave të Kosovës
- Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës
- Banka ProCredit
- Banka NLB Prishtina
- Banka Private e Biznesit
- Banka Ekonomike
- Banka TEB
- Banka BKT
- Banka Raiffeisen

Agjencia, me qëllim të informimit dhe promovimit të të drejtave për mbrojtjen e të dhënave ka shprehur gatishmërinë për të organizuar apo marrë pjesë në çfarëdo organizimi i cili bëhet nga organet publike dhe private ku do të ndahej me të pranishmit njohuritë dhe ekspertiza e fituar në fushën e mbrojtjes të dhënave personale. Kësaj gatishmërie i janë përgjigjur një numër i konsiderueshëm i organeve publike dhe private ku pjesëmarrja dhe interesimi e zyrtarëve të organeve të lartë përmendura ka qenë e lartë. Është vërejtur interesim më i madh i organeve private për të organizuar seminare të kësaj natyre.

Duke ditur rëndësinë e përpunimit të të dhënave personale në sektorin e Policisë, Prokurorisë dhe Shëndetësisë, Agjencia, përmes projektit të TAIEX ka organizuar dy punëtori ku ligjërues kanë qenë ekspertët e fushave nga BE-ja.

Me qëllim që qytetarët të jenë të informuar me të drejtat e tyre, për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë, Agjencia, ka hartuar dhe shpërndarë tri fletëpalosje, me të cilat është synuar që qytetari të informohet lidhur me detyrat dhe obligimet e Agjencisë, si dhe me të drejtat e qytetarit që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

Duke ditur rëndësinë dhe sasinë e përpunimit të të dhënave personale nga ana e Agjencisë së Regjistrimit Civil - ARC dhe duke pasur parasysh se qytetarët janë në baza ditore pranë zyreve të kësaj Agjencie, me qëllim të dyanshëm, që zyrtarët e Agjencisë së Regjistrimit Civil të njoftohen me detyrat dhe obligimet ligjore sa i përket mbrojtjes së të dhënave dhe në anën tjetër qytetari të njoftohet lidhur me të drejtat themelore të tij për mbrojtjen e të dhenave personale,

Agjencia në bashkëpunim me ARC ka hartuar broshurën " Regjistri Civil dhe Mbrojtja e të Dhënave", e cila është sponsorizuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Në kuadër të zhvillimeve të mëdha në fushën e teknologjisë informative, shfrytëzimi i Internetit është sfidë e madhe e mbrojtjes së të dhënave personale dhe e privatësisë. Për atë është nevojë e domosdoshme e kohës që të shfrytëzojmë të gjitha lehtësitë që na ofron teknologjia informative, por njëkohësisht të krijohen mundësi të mbrohen të dhënat personale dhe privatësia. Kjo sfidë, jo vetëm për ne por në nivel global ka dy kahje, njërën anë zhvillimi i politikave të privatësisë nga e ofruesve të shërbimeve në fushën e teknologjisë informative dhe në anën tjetër edukimin e qytetarëve për mënyrën e sigurtë të shfrytëzimit të Internetit. Në bazë të vlerësimeve paraprake, shfrytëzuesit më të mëdhenj të internetit është grupmosha e të rinjve dhe fëmijëve dhe si rrjedhojë e kësaj janë edhe më të rrezikuarit. Me qëllim që të kontribuojmë sadopak në edukimin e fëmijëve për shfrytëzimin e sigurtë të internetit, Agjencia ka bashkëpunuar me Qendra për Studime të Avancuara-FIT, në nxjerrjen e broshurave me temat në lidhje me përdorimin e sigurtë të Internetit. Kjo qendër tani më ka edhe një faqe në Internet në lidhje me edukimin e fëmijëve dhe prindërve për përdorimin e sigurtë të Internetit (www.internetisigurt.org).

Po ashtu edhe në aspektin e paraqitjeve mediale, Agjencia ka qenë prezente edhe në mediumet elektronike dhe në ato të shkruara, krejt kjo me qëllim të sensibilizimit të opinionit publik për rolin dhe aktivitetet e Agjencisë. Aktivitetet e Agjencisë janë përcjellur dhe plasuar nga Radio Televizionin e Kosovës, Kosovapress, Radio Kosova, Tribuna, Koha Ditore etj., por nuk kanë munguar publikimet në Zëri, Kosova Sot, Bota Sot, Epoka e Re, Gazeta Express, Gazeta Lajm, Koha Vizioni, TV Klan Kosova, RTV-21, Radio Dukagjini dhe portalet e ndryshme informative.

Gjatë vitit 2012 me tema të ndryshme të mbrojtjes së të dhënave personale, janë bërë rreth 59 publikime të ndryshme që kanë pasur për qëllim informimin dhe promovimin e të drejtave për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë këtu edhe konferencat për shtyp të organizuara nga Agjencia.

Përkundër një paraqitjeje të tillë të larmishme si në mediumet e shkruara dhe ato elektronike, vlerësojmë se mbetet akoma shumë për të bërë që qytetarët të jenë mirë të informuar si për të drejtat e tyre ashtu dhe me zhvillimet në nivel vendi dhe ato ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të privatësisë.

Meqë informimi dhe promovimi i të drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë është një ndër detyrat primare të Agjencisë, njëkohësisht sfidë si në aspektin e kapaciteteve njerëzore ashtu edhe materiale, Agjencia ka arritur të nënshkruajë një memorandum të bashkëpunimit me televizionin publik RTK, me qëllim që të arrijmë deri te qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të projektit që Agjencia ka për rritjen e informimit, promovimit, transparencës si dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me qytetarë, ka funksionalizuar faqen e saj zyrtare, në të cilën jemi vazhdimisht duke punuar që të plotësohen nevojat dhe kërkesat e kohës si dhe të jetë sa më leht e qasshme nga të gjitha palët e interesuara.

Web faqja zyrtare e Agjencisë është **www.amdp-rks.org**, ndërsa adresa zyrtare informuese është **info.amdp@rks-gov.net**.

Ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtat e tyre themelore për mbrojtjen e të dhënave personale ka qenë sfidë gjatë vitit 2012 dhe Agjencia synon që gjatë vitit 2013 të ketë si fokus të veçantë subjektin e të dhënave, respektivisht qytetarin e Republikës së Kosovës.

5.8 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Në përmbushje të obligimeve dhe detyrave ligjore, marrë në përgjithësi në fushën e bashkëpunimit për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia ka qenë aktive si në bashkëpunimin e brendshëm poashtu edhe atë ndërkombëtar.

Agjencia, në objektivat e vitit 2012, mes tjerash, në fokus ka pasur vënien e kontakteve dhe bashkëpunimit në nivel bilateral në rajon dhe më gjerë.

Në kuadër të kësaj, Agjencia ka zhvilluar vizita me autoritetet në vijim:

- Ambasadën e Finlandës në Prishtinë (shkurt, 2012);
- Komisioneren për Informim të Sllovenisë (mars, 2012), Lubjanë;
- Komisionerin për Informim dhe Mbrojtje të të Dhënave Personale në Zvicër (korrik 2012);
- Ambasadën e Francës, Ambasadorin Fransua Fitu (korrik, 2012), Prishtinë;
- Ambasadën e Zvicrës, Ambasadoren fuqiplote të Shtetit Zvicranë (qershor, 2012), Prishtinë;
- Komisionerin Federal të Gjermanisë, (dhjetor, 2012). Vizita është përkrahur nga TAIEX-i;
- Shefin e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Saksonisë, në Dresden të Gjermanisë (dhjetor 2012). Vizita është përkrahur nga TAIEX-i;
- Komisioneren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Bullgarisë, (shtator, 2012), Prishtinë;
- Komisioneren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shqipërisë, (shtator, 2012), Prishtinë;
- Kryetarin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtje të Dhënave Personale të Malit të Zi (qershor dhe shtator, 2012), Prishtinë;
- Kryetarin e Agjencisë Shtetërore të Kroacisë, (gusht, 2012), Prishtinë;

Ndërsa vizitat kanë qenë të shpeshta me Zyrën Ndërlidhëse të BE-së në Prishtinë. Të gjitha takimet në këto nivele janë zhvilluar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale me qëllim të mbështetjeve reciproke dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të institucionit, këmbimit të njohurive në lëminë e mbrotjes së të dhënave personale dhe ndjekjen e zhvillimeve të reja në fushën e teknologjisë informative e cila përdoret në përpunimin e të dhënave personale. Vizita të ndryshme që kanë pasë për qëllim mbrojtjen e të dhënave personale janë zhvilluar edhe me antarët e komisionit për siguri, njëherit deputetë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësuesit e Këshillit dhe Komisionit Evropian për përcjelljen e zhvillimeve në fushën e liberalizimit të

vizave nga ekspertë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, si dhe ekspertë të organizatave të ndryshme që veprojnë në Kosovë.

5.9 Bashkëpunimi Bilateral dhe Multilateral

Në saje të vizitave zyrtare të realizuara me qëllim të vënies së kontakteve të para dhe informimit rreth fushëveprimit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, janë ndërmarrë aktivitete konkrete, në kuadër të të arriturave nga vizitat e lartpërmendura, më poshtë po përmendim memorandumet e bashkëpunimit të lidhura me organizatat homologe të këtyre vendeve:

- Deklarata e Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave të Republikës së Kosovës, Bullgarisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi;
- Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave të Republikës së Kosovës, Bullgarisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi, nënshkruar më 26.09.2012;

- Deklarata e Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë;
- Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë, nënshkruar më 08.08.2012;

- Deklaratë mbi bashkëpunimin e mëtejshëm Ndërmjet Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Republika e Malit të Zi dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nënshkruar më 20.01.2012;

- Deklarata mbi Bashkëpunimin e Mëtejshëm ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Republika e Sllovenisë dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nënshkruar më 09.03.2012.

Përveç bashkëpunimit ndërkombëtar Agjencia ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e brendshme, si:

- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Radio Televizonit Publik të Kosovës, nënshkruar më 23.05.2012;

- Memorandum Mirëkuptimi për Mbështetje dhe Bashkëpunim lidhur midis: Policisë së Kosovës – përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale - përfaqësuar nga Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror, nënshkruar më 23.05.2012.

Memorandumet e lartcekura parashohin arritjen e këtyre objektivave të përbashkëta:

- Zhvillimin e legjislacionit;
- Bashkëpunimin me aktorë ndërkombëtarë me qëllim të arritjes së një zgjidhjeje të harmonizuar të problemeve të ndryshme;
- Shkëmbimin e përvojës në fushën e zhvillimeve të reja teknologjike;
- Aplikimi në projektet e financuara nga Bashkimi Evropian;
- Shkëmbimin e informacionit në dispozicion të publikut në lidhje me standardet e reja evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Vizita dhe shkëmbimin e ekspertëve me qëllim të studimit të tipareve të funksionimit të sistemit institucional të mbrojtjes së të dhënave personale në shtetet e palëve;
- Trajnimin dhe pjesëmarrjen në tryeza të rrumbullakëta;

Agjencia ka marrë pjesë edhe në shumë aktivitete ndërkombëtare si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Po veçojmë pjesëmarrjen në konferenca me tematikë nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale në Mal të Zi, Shqipëri në tri konferenca me tematikë nga fusha e telekomunikacionit, mediumeve dhe forcimi ligjor i komisionerit, në Maqedoni me temën Modernizimi i Legjislacionit të MDHP në nivel evropian, dhe konferenca ballkanike - multishtetërore e autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave personale.

Brenda vendit, Agjencia ka marrë pjesë aktive në shumë konferenca me tema në rrafshin e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale të organizuara nga shoqëria civile si: Lesna, Instituti për Studime të Sigurisë etj. të karakterit ndërkombëtare, me fokus në regjionin tonë, në dy konferenca-tryeza të organizuara në fushën e integrimeve evropiane, me përfaqësues të Komisionit Evropian. Janë mbajtur tryeza dhe takime të rregullta me ILEKUN, lidhur me këmbimin e informacionit në fushën e sundimit të ligjit dhe të sigurisë në Kosovë.

Por, vlenë të veçohet nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit multilateral, në shtator 2012, në mes të katër shteteve të regjionit: Bullgarisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, ku regjionit i sollën një "shengen" të ri në këtë sferë. Ndërkohë që nga ky aktivitet RTK-ja organizoi emision special me autoritet udhëheqëse të këtyre shteteve.

5.10 Caktimi i Zyrtarit Mbrojtës

Agjencia me qëllim të kompletimit të kornizës ligjore, sa i përket caktimit të zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave - ZMDH dhe në harmoni me zhvillimet evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me theks të veçantë të caktimit të zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave, ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ për Caktimin e Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Agjencia konsideron se caktimi i zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave është me rëndësi të veçantë si për organin i cili e cakton atë, ashtu dhe për ne si organ mbikëqyrës. Gjatë përvojës së shkurtër, tashmë rreth 18 muaj, kemi konstatuar se të gjitha organet të cilat kanë caktuar ZMDH-të, jo vetëm që kanë treguar përkushtimin e respektimit të dispozitave ligjore për përcaktim të zyrtarit, por është vërejtur dhe vullneti i tyre për bashkëpunimin e mëtutjeshëm në respektimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Duke veçuar me këtë rast dhe angazhimin e madh të shumicës së ZMDH-së për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë, që jo rrallë ka rënë ndesh me politikat e organit të cilin e ka përfaqësuar.

Duke parë produktivitetin që sjell caktimi i ZMDH-së, Agjencia ka drejtuar me dhjetra shkresa dhe ka mbajtur me dhjetra takime, jo vetëm për të bindur organet për zbatimin e dispozitave ligjore por për t'u shpjeguar rëndësinë që ka ZMDH në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë.

Angazhimi ynë në këtë drejtim ka sjellë më shumë fryte tek organet private se tek ato publike. Në veçanti hasim në një neglizhencë të organeve publike të nivelit lokal në caktimin e ZMDH-së. Mbesim të përkushtuar në organizimin dhe mbajtjen e takimeve me përgjegjësitë e organeve publike dhe private me qëllim të sqarimit të rëndësisë së caktimit të ZMDH-së.

Tabela 1, Regjistri i zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave personale të caktuar në institucionet publike / private:

- Administrata Tatimore e Kosovës
- Agjencia e Kosovës për Forenzikë
- Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
- Agjencia e Regjistrimit Civil
- Agjencia Kosovare e Privatizimit
- Agjencia Kundër Korrupsionit
- Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla
- Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
- Agjencia për Promovimin e Investimeve
- Agjencia për Regjistrimin e Biznesit
- Komuna Ferizaj
- Komuna Istog
- Komuna Kamenicë
- Komuna Novobërdë
- Komuna Obiliq
- Komuna Partesh
- Komuna Prishtinë
- Komuna Prizren
- Komuna Shtërpcë
- Komuna Shtime (nuk e ka kryer asnjë aktivitet të dhënë sipas Ligjit 03/L-172)

- Agjencia për Standardizim
- Agjencia Qendrore e Prokurimit
- Agjencioni për Financim në Kosovë
- Akademia e Kosovës për Siguri Publike
- Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
- Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
- Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
- Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
- Banka Ekonomike
- Banka Kombëtare Tregtare
- Banka Private e Biznesit
- Banka Qendrore e Kosovës
- Dogana e Kosovës
- Gjykata Kushtetuese
- Inspektoriati Policor i Kosovës/MPB
- Institucioni i Avokatit të Popullit
- Instituti Albanologjik
- Instituti Historisë
- Instituti Pedagogjik
- IPKO - Telecommunications
- KEP Trust Microfinance
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës për Sherbimin Civil të Kosovës
- Këshilli Prokurorial i Kosovës
- Kompania e Sigurimeve Illyria Sh. A.
- Komuna Dragash
- Komuna e Fushë-Kosovës
- Komuna e Graçanicës
- Komuna e Lipjanit
- Komuna e Mitrovicës
- Komuna Vushtrri
- Kosova Aid and Development
- Kuvendi i Kosovës (Administrata)
- Kuvendi i Kosovës (Deputetët)
- Ministria e Financave
- Ministria e Administratës Publike
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
- Ministria e Diasporës
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Infrastrukturës
- Ministria e Integrimeve Evropiane
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria e Punëve të Brendshme
- Ministria e Punëve të Jashtme
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Ministria për Forcën e Sigurisë
- Ministria për Komunitet dhe Kthim
- NLB - Prishtina
- Organi Shqyrtues i Prokurimit
- Organi Shqyrtues i Prokurimit
- Policia e Kosovës
- Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
- ProCredit Bank
- Spitali Rajonal Gjakovë
- TEB SH.A.
- Trainkos SH.A.
- Universiteti Shtetëror i Prizrenit
- Zyra e Kryeministrit
- Zyra e Presidentit të Kosovës
- Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina

Agjencia, gjatë vitit 2012 ka organizuar dhe mbajtur trajnimin dyditor për ZMDH-në, në bashkëpunim të përbashkët me IKAP-në, ka organizuar seminare, punëtori dhe mbanë takime të rregullta duke qenë në kontakt të vazhdueshëm pothuajse në baza ditore me ta.

5.11 Regjistrimi i Dosjeve dhe Vëzhgimi me Kamerë

5.11.1 Regjistrimi i Dosjeve

Agjencia, në bashkëpunim me ekspertët e TAIEX-it ka hartuar dhe nxjerrë rregulloren për Mënyrën e Mbajtjes së Regjistrit të Sistemit të Dosjeve të të Dhënave Personale dhe Formularin e kërkesës për regjistrimin e sistemit të dosjeve. Gjithashtu, pjesë e këtij projekti të TAIEX-it është edhe zhvillimi i aplikacionit që do të mundësonte aplikimin dhe regjistrimin *online* përmes faqes zyrtare të Agjencisë. Përkundër angazhimit të përbashkët, zhvillimi i aplikacionit ka marrë shumë kohë, duke shtyrë në këtë rast inicimin e fillimit të regjistrimit të dosjeve të kontrollorëve.
Pavarësisht realizimit të aplikacionit për regjistrim *online*, Agjencia do të fillojë regjistrimin në fjalë gjatë vitit 2013.

5.11.2 Vëzhgimi me Kamerë

Me qëllim të respektimit të dispozitave ligjore të cilat rregullojnë vëzhgimin me kamerë në sektorin publik dhe privat, Agjencia, në bashkëpunim me ekspertët e TAIEX-it, ka hartuar udhëzuesin për vëzhgim me kamerë. Kjo për arsye se është një tendencë e vazhdueshme e shfrytëzimit të madh të mbikëqyrjes me ndihmën e kamerave, gjë e cila është mundësuar me zvogëlimin e vazhdueshëm të kostos së instalimit të sistemit të vëzhgimit me kamerë. Kjo ka sjellë si produkt shfrytëzimin vend e pa vend, në kundërshtim me rregullat ligjore të cilat përcaktojnë mënyrën e përdorimit të vëzhgimit me kamerë.
Agjencia, në kuadër të masave për informimin e lehtë të qytetarëve për hapësirat që vëzhgohen me kamerë ka nxjerrë formatin standard të aplikueshëm në tërë Republikën e Kosovës, për të gjitha organet publike dhe private.

Shenja Paralajmëruese Standarde

Aplikimi i njoftimit standard, ka për qëllim që qytetari të ketë mundësi të lehtë të familjarizohet me shenjën paralajmëruese për hapësirat e vëzhguara me kamerë.

Agjencia ka ndërmarrë një fushatë mediale me ndihmën e televizionit publik RTK, për aplikimin e formatit standard të njoftimit që organet publike dhe private të aplikojnë formatin standard si shenjë paralajmëruese për hapësirat e vëzhguara me kamerë. Në kuadër të kësaj fushate Agjencia ka ofruar falas standardin e njoftimit të shtypur për të gjitha organet publike dhe private. Duke ofruar edhe mundësinë e shkarkimit të njoftimit standard edhe përmes faqes zyrtare të Agjencisë.

Si rezultat i kësaj fushate janë shpërndarë 2981 shenja paralajmëruese të standardizuara për 190 organe publike dhe private.

Agjencia, përveç kompletimit të kornizës ligjore lidhur me vëzhgimin me kamerë, ka bërë inspektime në bazë të detyrës zyrtare dhe inspektime të rregullta në një numër të madh të organeve publike dhe private.

Mund të konstatojmë që në territorin e Republikës së Kosovës pjesa dërmuese e organeve publike dhe private aplikon formatin standard të njoftimit për hapësirat të cilat vëzhgohen me kamerë. Në kuadër të kësaj mund themi që ky standard njoftues ka nivel të lartë aplikimi i cili në relacion me vendet fqinje është mbi nivelin e rajonit tonë.

5.12 Financat dhe Buxheti - Aktivitetet nga ndarja buxhetore janar-dhjetor 2012

Bazuar në rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, në vitin 2012 ASHMDHP-së i është aprovuar buxheti i përgjithshëm në shumë prej **274,000.00 €**.

Me rishikim buxhetor kemi tërhequr edhe 26,000.00 € që dmth buxheti i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2012 ishte 300,000.00 € i ndarë në kategoritë kryesore si në vijim:

Tabela 1.1 Buxheti i ASHMDHP-së, viti 2012

Përshkrimi	**Shuma €**
Paga dhe mëditje	152,000.00
Mallra dhe shërbime	111,000.00
Shpenzime komunale	8,000.00
Pasuritë Jofinanciare	29,000.00
Total	**300,000.00**

5.13 Shpenzimet Buxhetore

Financimi i aktiviteteve të ASHMDHP-së, sipas klasifikimeve ekonomike është paraqitur në tabelën e mëposhtme. Janë shpenzuar € 282,000.00 si në vijim:

Tabela 1.3 Buxheti i shpenzuar

Përshkrimi	**Shuma €**
Paga dhe mëditje	142,000.00
Mallra dhe shërbime	106,000.00
Shpenzime komunale	8,000.00
Pasuritë Jofinanciare	26,000.00
Total	**282,000.00**

Mjete të pashfrytëzuara kanë mbetur në paga dhe mëditje 10,000.00 €, në mallra dhe shërbime 5,000.00 € dhe kapitale 3,000.00 € (gjithsej suficit 18,000.00 €).

Sipas kategorive ekonomike, shkalla e shpenzimeve buxhetore është e paraqitur në përqindje (%).

Tabela 1.4 Shpenzimet buxhetore të shprehura në %

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Shpenzimet në %
Paga dhe mëditje	152,000.00	142,000.00	93%
Mallra dhe shërbime	111,000.00	106,000.00	95%
Shpenzime komunale	8,000.00	8,000.00	100%
Pasuritë Jofinanciare (kapitale)	29,000.00	26,000.00	90%
Total	**300,000.00**	**282,000.00**	**94%**

Tabelat në vazhdim pasqyrojnë shpenzimet e ASHMDHP-së sipas nënkategorive kryesore ekonomike.

Tabela 1.5. Pagat dhe mëditjet (personeli dhe Këshilli i ASHMDHP-së)

Paga dhe mëditjet	Shuma €
Paga neto	119,000.00
Tatim i ndalur në të ardhura personale	9,000.00
Kontribute pensionale të punëdhënësit	7,000.00
Kontribute pensionale të të punësuarve	7,000.00
Gjithsej paga dhe mëditje	**142,000.00**

Tabela 1.6. Mallrat dhe shërbimet

Përshkrimi	Shuma
Shpenzimet e udhëtimit	14,000.00
Shërbimet e telekomunikimit	11,000.00
Shpenzimet për shërbime	2,000.00
Mobiljet dhe pajisjet nën 1000 Euro	5,000.00
Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	7,000.00
Derivatet dhe lëndët djegëse	9,000.00
Qiraja	46,000.00
Shpenzimet e marketingut	2,000.00
Shpenzimet e përfaqësimit	10,000.00
Gjithsej mallra dhe shërbime	**106,000.00**

Tabela 1.7. Shpenzimet komunale

Përshkrimi	Shuma
Rryma	5,000.00
Uji	1,000.00
Shpenzime të telefonisë fikse	2,000.00
Gjithsej shpenzime komunale	**8,000.00**

6. VLERËSIMET E PËRGJITHSHME DHE REKOMANDIMET PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë në Republikën e Kosovës është ende para shumë sfidave. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtën themelore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë mbetet në nivelin ende për të dëshiruar. Kjo është edhe arsye pse Agjencia si fokus të veçantë ka vënë qytetarin në krye të interesimit të saj për të njoftuar dhe promovuar të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë. Gjersa niveli i njohurisë për të drejtat dhe obligimet që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke marrë në përgjithësi mbrojtjen e të dhënave personale në nivel vendi, nga ana e organeve publike dhe private, pas një aktiviteti të gjerë të Agjencisë, gjatë vitit 2012, konsiderohet se është në nivelet e kënaqshme. Deri te ky vlerësim arrijmë në bazë të nivelit të interesimit të shprehur përmes kërkesave për këshilla, mendime si dhe zbatimit të plotë të të gjitha vendimeve të nxjerra nga Agjencia. Duke veçuar me këtë rast vështirësitë që në vazhdimësi kemi me caktimin e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale nga ana e organeve publike të nivelit lokal.

Mungesa e përcaktimit të qartë të kategorive të të dhënave personale të nevojshme për përpunimin e të dhënave personale nga ana e organeve publike dhe private, është një ndër mungesat më të mëdha të legjislacionit në fuqi. Mungesa e këtij përcaktimi lë hapësirë që organet publike dhe private të mbledhin dhe grumbullojnë sasi të mëdha të të dhënave personale, që jo rrallë këto të dhëna janë të panevojshme dhe në kundërshtim me parimet e përpunimit të të dhënave të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Shqetësim i veçantë si pasojë e asaj që u cek më lart është mbajtja e fotokopjeve të dokumenteve të identifikimit, pothuajse në të gjitha rastet kur organet publike dhe private ofrojnë ndonjë shërbim.
Andaj rekomandojmë që në të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore ku definohet përpunimi i të dhënave personale, të përcaktohen qartë kategoritë e të dhënave që do të përpunohen me atë rast.

Përpos mungesës së kornizës ligjore të qartë, që përcakton kategoritë e të dhënave që mundë të përpunohen, njëkohësisht në shumicën e rasteve mungon dhe koha e ruajtjes, ku si pasojë kemi grumbullimin dhe mbajtjen e të dhënave personale me vite të tëra përkundër arritjes së qëllimit për të cilën fillimisht janë grumbulluar.
Gjatë vitit 2012 vetëm te një operator i telefonisë mobile, pas vendimit të Agjencisë, janë shkatërruar miliona kopje të dokumenteve identifikuese. Shumë dokumente të tilla të ngjashme presin vendimin e Agjencisë për tu shkatërruar.

Andaj, rekomandojmë që në të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore ku definohet përpunimin e të dhënave personale, të përcaktohet qartë koha e ruajtjes të dhënave.

Gjersa gjatë vitit 2011 në Agjenci ka arritur vetëm një akt nënligjorë për konsultim, gjatë vitit 2012 ka arritur një numër i konsiderueshëm për konsultim, prapë numri i ligjeve të ardhura në konsultim është shumë më i vogël sesa numri i ligjeve të cilat janë shqyrtuar dhe aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ne mbesim të përkushtuar që të japim kontributin në të gjitha rastet kur aktet ligjore apo nënligjore vijnë për konsultim pranë Agjencisë, duke kryer me këtë rast obligimin ligjor që ka Agjencia për tu konsultuar nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës me rastin e hartimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale. Për zbatimin e këtij detyrimi ligjor Agjencia ka bërë njoftimin me shkrim për Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës në janar 2012.

Duke vërejtur tendencën e madhe të organeve publike dhe private për përdorimin e vëzhgimit me kamerë, Agjencia, në harmoni me ligjin, ka ndërmarrë një sërë veprimesh që vëzhgimi me kamerë të bëhet në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Duke u fokusuar në kompletimin e kornizës ligjore dhe fushatën mediale ndërgjegjësuese me qëllim që organet publike dhe private të jenë të udhëzuara për të kryer vëzhgimin e ligjshëm me kamerë. Përveç fushatës mediale dhe nxjerrjes së akteve nënligjore, Agjencia ka kryer inspektime me fokus ligjshmërinë e vëzhgimit me kamerë. Është konstatuar se në shumicën e rasteve ka munguar vendimi për përdorimin e kamerave, qëllimi i vendosjes së kamerave ka tejkaluar qëllimet që përcakton ligji dhe jo rrallë hapësirat e vëzhguara kanë qenë në kundërshtim me dispozitat ligjore.
Shqetësuese është tendenca e përdorimit masiv të vëzhgimit me kamerë në shkollat fillore dhe të mesme. Duke vërejtur këtë tendencë Agjencia planifikon që gjatë viti 2013 përmes takimeve informuese, seminareve ndërgjegjësuese dhe inspektimeve të parandalojë cenimin e privatësisë së nxënësve si pasojë e vëzhgimit me kamerë.

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në nivel vendi, në fushat ku bëhet përpunim i madh i të dhënave personale si: në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme; Agjencia në muajin tetor 2012, ka nxjerrë rekomandimin për caktimin e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale, në këto organe me përshkrim të punës dhe detyrave të punës me prioritet në këtë fushë, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Konsiderojmë se implementimi i këtij rekomandimi sjell performancë në mbrojtjen e të

dhënave personale, siguri dhe besim të subjekteve të të dhënave, të institucionet, përkatësisht kontrollorët që përpunojnë të dhëna personale.

Përceptimi i përgjithshëm i qytetarëve të Republikës së Kosovës, sidomos pas zbulimit të paautorizuar të incizimeve të bisedave telefonike të zyrtarëve të lartë shtetërorë është se përgjimi është duke u kryer jo në harmoni me legjislacionin në fuqi, duke reflektuar me këtë rast një pasiguri në shfrytëzimin e mjeteve të komunikimit. Agjencia, ka qenë e tanguar si "e pafuqishme për të mbrojtur të dhënat personale", në këtë rast përpunimin e zërit si e dhënë unike identifikuese personale dhe ndërhyrja për përgjim. Agjencia përmes deklaratave për shtyp dhe paraqitjen e saj publike ka bërë të qartë shqetësimet e saj për mosrespektimi e legjislacionit në fuqi me rastin e përpunimit të të dhënave personale – zërit, në rastin e përgjimeve.

Rekomandohet kompletimi i kornizës së plotë ligjore, e cila rregullon përgjimin e ligjshëm, duke përcaktuar qartë mekanizmin e pavarur mbikëqyrës, për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë në harmoni me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ashtu siç kemi theksuar në Raportin e Punës të vitin 2011, mosratifikimi i Konventës *"për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale"* e njohur si Konventa 108 e BE-së, ka pamundësuar që Agjencia të anëtarësohet dhe të jetë pjesë e aktiviteteve të organizmave të ndryshëm evropianë të fushës së mbrojtjes së të dhënave personale. Përpos pamundësisë së pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme të organizuara nga organizmat evropianë, pasojë e mosratifikimit të konventës së lartcekur është pengesë serioze që Republika e Kosovës të jetë pjesë e listës së shteteve që ofrojnë nivelin e duhur të sigurisë së të dhënave personale.

I rekomandojmë Qeverisë së Republikës së Kosovës të ketë si objektiv zgjedhjen e mënyrës së procedimit të konventës *"për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale"*, për ratifikim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.